



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0070

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga, Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani - Anëtare, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik - EL-BAU SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Asfaltimi,kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë me nr. të prokurimit: 651-22-11127-5-1-1, iniciuar nga KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, në cilësinë e autoritetit kontraktues, me datën 13/06/2023, mori:

Vendim

1. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik OE “EL-BAU SH.P.K.”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 08/02/2023, numër protokollit 2023/0070, për aktivitetin e prokurimit Asfaltimi,kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë me nr. të prokurimit: 651-22-11127-5-1-1, iniciuar nga KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.
2. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 08.12.2022 për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: Asfaltimi,kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë me nr. të prokurimit: 651-22-11127-5-1-1, iniciuar nga KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.11.2023, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: Asfaltimi, kanalizimi dhe ndriçimi publik në rrugën Nëna Terezë me nr. të prokurimit: 651-22-11127-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -

Kuvendi Komunal-Gjilan. Me datën 23.01.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Me datë 30.01.2023, OE "EL-BAU" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 31.01.2023, AK - Kuvendi Komunal- Gjilan me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues EL-BAU SH.P.K., me datën 08.02.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0070, kundër njoftimit për kontratë të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 24.04.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues "El-Bau" sh.p.k., sh.p.k me seli në Gjilan të refuzohet si e pa bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 23.01.2023, (vendim për dhënie të kontratës).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE "El-Bau" sh.p.k., me seli në Gjilan

Operatori ekonomik ankues i pa kënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, parashtron ankesë në OSHP.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 1

OE ankues pretendon se AK pasi ka përfunduar procesin e vlerësimit dhe shqyrtimit të tenderëve, nuk ka dal me vendim përfundimtar, mirëpo pas 43 ditëve pas hapjes së ofertave, bene anulimin e aktivitetit të prokurimit përmes Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me arsyetimin se gjoja të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale tejkalojnë vlerën e parashikuar të kontratës dhe se njësia kërkuese ka konfirmuar se nuk ka mjete shtesë për të vazhduar më tutje me këtë aktivitet. Në pikëpamje faktike dhe ligjore arsyetimi për anulim nuk qëndron në mënyrën e paraqitur sepse mënyra e paraqitur është e bazuar në projektin

dhe para masën e janarit të vitit 2020 kur nuk kemi pasur ngritje të çmimeve apo shkallë të inflacionit në rang botëror që ka rezultuar pas situatës me pandemi dhe mandej pas invazionit të Rusisë në Ukrainë. Gjithashtu OE pretendon se anulimi i aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me frymën e Ligjit Nr.08/L-183 për mbështetje publike, vendimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve Nr.3047/22 të dt.27.12.2022 që kompanive të sektorit të ndërtimit ju ka njohur të drejtën e kompenzimit për kontratat aktive të punës të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore dhe punës përcjellëse për kontratat publike.

Eksperti Shqyrtues, pasi ka analizuar dokumentacionin e ofruar në E prokurim, për këtë aktivitet të prokurimit, sqaron se hapja e ofertave është bërë me dt.12.12.2022 dhe Njoftimi mbi vendimin e AK-së është nxjerr me dt.23.01.2023, plot 43 ditë pas hapjes së ofertave. Sipas nenit 40.3 të Rregullores për prokurim publik thekson se Njoftimi mbi vendimin e AK-së do të kryhet jo më shumë se 30 ditë pas hapjes së ofertave dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të zgjatet edhe për 20 ditë. Në rastin konkret në E prokurim nuk ka ndonjë dëshmi që AK ka bërë zgjatje të afatit për vlerësimin e ofertave.

Ndërsa në lidhje me arsyetimin e OE ankues se vendimi i AK-së është në kundërshtim me frymën e ligjit për mbështetje publike, eksperti shqyrtues sqaron se ligji i lartpërmendur i referohet vetëm kontratave aktive të cilat janë të lidhura para datës 1 Prill 2022, shih nenin 2 të ligjit, dhe nuk vlejnjë për aktivitetet të cilat janë në procedurë të prokurimit. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

OE ankues pretendon se me vendimin e kontestuar me anë të të cilit është anuluar aktiviteti i prokurimit pa ekzistuar asnjëra nga rrethanat dhe kërkesat ligjore të kërkuara me nenin 62 të LPP-se, konsiderojmë se AK është duke rrezikuar sigurinë juridike, sistemin juridik dhe pritshmërinë legjitime dhe të arsyeshme për faktin se po krijon përshtypje sikurse vendimet e AK-se janë të karakterizuara nga interesat e tjera e jo ato legjitime. Në rastin konkret tejkalohet afati i rregullt për vlerësimin e tenderëve në atë mënyrë që nga procesi i hapjes së tenderëve (dt.12.12.2022) procesi i vlerësimit zgjat plot 43 ditë dhe në fund nxirret vendim për anulim të aktivitetit. AK-së i duhet 47 ditë për të ardhur në përfundim për të anuluar aktivitetin për një shkak që ka qenë i ditur për të qysh me rastin e hapjes së ofertave. Në këtë mënyrë, konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-se dhe nenin 40.3 të RRPP nr.001/2022.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se përfundimi i AP është paraparë në nenin 62 të LPP-së, në këtë aktivitet të prokurimit një ofertë është e papërgjegjshme dhe dy oferta kanë tejkaluar buxhetin e AK-së dhe në këtë rast gjen zbatim paragrafi 2.1 i Nenit 62 të LPP-së.

Eksperti Shqyrtues, vlerëson se AK nuk ka respektuar në tersi dispozitën e Nenit 40.3 të RRPP nr. 001/2022 me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, andaj konsideroj si pjesërisht të bazuar pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankues.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

OE ankues pretendon se AK përmes vendimit të datës 31.11.2022 ndaj kërkesës për rishqyrtim, arsyetimi i vendimit të kontestuar nuk i përmban dhe përmbush elementet që duhet të përmbaj arsyetimi i një vendimi administrativ në kuptim të nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu arsyetimi i vendimit kontestues nuk është në përputhje as me kriteret ligjore të parapara në nenin 108/A paragrafi 12 të LPP-se, për faktin se përmbajtja e tij nuk ka qenë i bazuar në analizën e rrethanave dhe fakteve relevante, mirëpo është parafrazim fjalë për fjalë i vendimit të dt. 31.01.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se AK me dt.31.01.2023 me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ekonomik ankues, duke i përmendur edhe arsyet e përfundimit të këtij aktiviteti të prokurimit, andaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues për faktin se AK i ka dhënë arsyet e eliminimit të OE ankues.

Sqarim,

Eksperti Shqyrtues, mendon se AK është thirrur gabimisht në paragrafin 1.1 të nenit 62 me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, por është dashur të thirret në paragrafin 2.1 të Nenit 62 të LPP-së. Gjithashtu evidentimi i faktit në vendim nga ana e Zyrës së Prokurimit të AK-së se i ka kërkuar Njësisë kërkuese konfirmimin e mjeteve për të vazhduar me aktivitetin e prokurimit, të cilët kanë konfirmuar se nuk kanë mjete, konsideroj se është e gabuar për faktin se tejkalon kompetencat e njësisë kërkuese të përcaktuara në Nenin 10 të Rrpp Nr.001/2022, Zyra e prokurimit nëse ka pasur interes ta përfundojë këtë aktivitet të prokurimit ka mundur t'i drejtohet ZKF-së dhe ZKA-së së institucionit, që nëse kanë mjete që të mund të vazhdojnë me AP.

Eksperti Shqyrtues, vlerëson se në këtë aktivitet të prokurimit AK ka bërë shkelje procedurale mirëpo të cilat nuk ndikojnë në rezultatin final të këtij AP. Andaj eksperti shqyrtues e sheh ankesën e OE ankues si të pa bazuar, dhe rekomandon që të anulohet aktiviteti i prokurimit konform paragrafit 2.1 të Nenit 62 të LPP-së. Nëse edhe më tutje AK ka interes për këtë aktivitet të prokurimit mund ta iniciojë përsëri.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli në aspektin përmbajtësor dhe në kontest të të gjeturave të tij dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE ankues "El-Bau" sh.p.k., me seli në Gjiilan të hedhet poshtë si e palejuar dhe që të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 08.12.2022.

Si çështje përcaktuese kyçe që ka sjellur deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi ka qenë çështja e eliminimit të OE ankues nga ky aktivitet prokurimi nga ana e AK me arsyeshmërinë e tejkalimit të vlerës së parashikuar, konkretisht aplikimit të nenit 62 të LPP-së, Paneli Shqyrtues, vlerëson se përfundimi i AP është paraparë në nenin 62 të LPP-së, në këtë

aktivitet të prokurimit bazuar në të dhënat në e-prokurimi një ofertë është e papërgjegjshme dhe dy oferta kanë tejkalluar buxhetin e AK-së dhe në këtë rast gjen zbatim paragrafi 2.1 i Nenit 62 të LPP-së, i cili më mënyrë specifike parasheh që: *1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;*, andaj duke u bazuar në nenin 62, PSH konstaton se është përgjegjësi e AK-së që vlerën e parashikuar ta përcaktojë duke u bazuar në çmimet e tregut, çmimet e kontratave paraprake nëse ato ekzistojnë dhe analizë të kostove sipas specifikimeve, për më tepër, neni 13.2 i RROUPP saktëson se në parashikimin e vlerës së kontratës, përveç tjerash vlen të theksohet se përgjatë përpilimit të DT dhe NJK palët kanë të drejtën e sqarimit e po ashtu të inicimit të procedurave ankimore para dorëzimit të ofertave të tyre, andaj duke qenë se në këtë aktivitet nuk janë evidentuar veprime të tilla të ndërmmarrura, PSH vlerëson se është përgjegjësi dhe diskrecion i AK-së menaxhimi dhe alokimi me mjete financiare, parashikimi i projekteve andaj në këtë rast duke u bazuar në të gjitha që u thanë si më sipër mund të konstatohet se edhe anulimi i procedurës në rastet kur tejkalohe buxheti i AK-së (vlera e parashikuar) qëndron në përgjegjësi të plotë të tyre konform legjislacionit në fuqi, përveç tjerash, paneli shqyrtues ka konsideruar edhe pretendimet ankimore në të cilat OE ankues ka potencuar aktivitete të tjera të prokurimit që i njëjti AK ka zhvilluar duke kaluar vlerën e parashikuar, por në rastin konkret, këto çështje si dhe veprimet apo mos-veprimet e ndërmarra në këtë kontest ne aspektin financiar janë çështje që janë jashtë juridiksionit dhe jashtë kompetencave të OSHP-së.

Lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në raportin e ekspertit si pretendimet me nr rendor 1 dhe 3, përkatësisht veprimet dhe mos-veprimet e ndërmarra në aspektin procedural nga ana e AK-së, PSH konform raportit të ekspertizës këto veprime procedurale i klasifikon si veprime që bien ndesh me legjislacionin në fuqi (pa nevojën për ti përsëritur sërish), megjithatë me qenë se të njëjtat nuk kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar, PSH konstaton se kundrejt AK-së (zyrtarit përgjegjës të prokurimit) lëshohet vërejtje përfundimtare përmes këtij vendimi, me kushtin që nëse në të ardhmen evidentohen lëshime/shkelje të njëjta apo të ngjashme, OSHP në kuadër të paneleve shqyrtuese do të ndërmmarrë masa konform nenit 131 të LPP-së duke ju drejtuar KRPP-së me kërkesë për revokim të certifikatës të prokurimit konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - EL-BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: